



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1972 prot

Korçë, më 29/09 / 2025

VENDIM

Nr. 526, datë 29.09.2025

PËR

RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT NGA BACHELOR NË
"MATEMATIKË-INFORMATIKË", NË "BACHELOR" NË "DATA
SCIENCE", 180 ECTS

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 38 pika dh, neni 35 pika 9, në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 18 pika 9, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "*Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë*", i ndryshuar, të MASR, si dhe në propozimin e departamentit të Matematikës dhe Fizikës, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane, për riorganizimin e programit të studimit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.09.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të studimit Bachelor në "Matematikë-Informatikë", në "Bachelor" në "Data Science", 180 ECTS, ofruar në tre vite akademike nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, Departamenti i Matematikës dhe Fizikës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI
Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1974 prot

Korçë, më 29 / 09 / 2025

VENDIM

Nr. 528, datë 29.09.2025

PËR

MIRATIMIN E FORMËS TË DIPLOMËS SË GRADËS SHKENCORE
"DOKTOR" NË "STUDIME GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE NË
RAJONIN E BALLKANIT",

TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

Në zbatim të nenit 91, pikës 3 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 70 pika 4, të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, në Udhëzimin e MASR nr. 11, datë 02.04.2020 "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës" si edhe në udhëzimin e MASR nr.10, datë 30.3.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar", Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.09.2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e formës të Diplomës së Gradës Shkencore "Doktor" në "Studime Gjuhësore dhe Etnokulturore në Rajonin e Ballkanit".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

DIPLOMË DOKTORATE

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, i ndryshuar" si dhe në dokumentacionin e studimeve të kryera:

EMRI ATËSIA MBIEMRI

Lindur në _____ më __, __, __, regjistruar më __, __, __, në studimet e doktoratës, në "STUDIME GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE NË RAJONIN E BALLKANIT"

referuar nivelit 8-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me kohë të plotë, me nr. matrikullimi _____, nr. rendor në Regjistrin Themeltar _____, pasi mbrojti disertacionin me temë:

me Vendimin e Jurisë nr. _____ datë __, __, __, i jepet

DIPLOMË E GRADËS SHKENCORE

"DOKTOR"

**NË "STUDIME GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE NË
RAJONIN E BALLKANIT"**

DEKANI

REKTORI

Nr. rendor i regjistrimit të Diplomës në Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave të IAL-së _____

Nr. unik i formës së Diplomës Regjistrin Shtetëror të Diplomave _____

Nr. në Regjistrin Shtetëror të Gradave Shkencore dhe Titujve Akademikë _____

Nr. i matrikullimit të studimeve paraardhëse _____

Nr. i Diplomës të studimeve të ciklit paraardhës _____

Lëshuar në _____, më __, __, __



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1522 prot

Korçë, më 05/08 / 2025

VENDIM

Nr. 431, datë 05.08.2025

PËR
MIRATIMIN PARAPRAKISHT TË PROGRAMIT BUXHETOR VJETOR DHE
AFATMESËM PËR PERIUDHËN 2026-2028

Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë i mbledhur në datën .08.2025, për miratimin e programit Buxhetor Vjetor dhe Afatmesëm 2026-2028, konform synimeve dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit dhe Strategjinë Kombëtare për zhvillim dhe integrim 2021-2026, mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH", të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", të ligjit "Për buxhetin e shtetit", të Udhëzimit "Për përgatitjen e programit buxhetor vjetor dhe afatmesëm" të Ministrisë së Financave, si dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 38 pika h,

VENDOSI:

1. Të miratojë paraprakisht programin buxhetor vjetor dhe afatmesëm 2026-2028 konform synimeve dhe objektivave të përcaktuara në strategjinë e arsimit dhe strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2021-2026.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1416 prot

Korçë, më 07/07/2025

VENDIM

Nr. 398, datë 07.07.2025

PËR

MIRATIMIN E TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR ÇDO
PROGRAM STUDIMI DHE TARIFAVE PËR REGJISTRIMIN PARAPRAK
PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Mbështetur, në VKM nr. 288, datë 21.05.2018 për "Miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar, në VKM nr. 866, datë 23.10.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016", si dhe në VKM nr. 778, datë 26.12.2018, "Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar, pika 1 gërma a), Senati Akademik në mbledhjen online të datës 07.07.2025,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e tarifave të shkollimit për vitin akademik 2025-2026 për programet e ciklit të parë, për programet e ciklit të dytë dhe programet profesionale të studimit.
2. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e tarifave të regjistrimit paraprak 1,600 lekë për të gjitha programet e studimit Bachelor dhe programet profesionale, 2,500 lekë për të gjitha programet e studimit Master, dhe 3,000 lekë për program të dytë studimi.

3. Tarifa e regjistrimit për konkurrim në programin e studimit "Bachelor" në "Edukim fizik dhe sporte" do të jetë 5000 lekë/student.
4. Tarifa e rilëshimit të suplementit të diplomës do të jetë 1000 lekë/suplement diplome.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI**

Prof.dr. Lorenc Ekonomi



TARIFAT E STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Nr.	Emërtimi i programit të studimit	Lloji i programit (Bachelor/ Master Profesional/ Master i Shkencave, Program Profesional etj.)	Nr. kredite të programit të studimit	Tarifa vjetore e studimit	
				Program i parë studimi	Program i dytë studimi
1	Gjuhë - Letërsi	Bachelor	180 ECTS	20,000	35000
2	Gjuhë - letërsi shqipe dhe gjuhë pakicash	Bachelor	180 ECTS	20,000	35000
3	Gjuhë dhe Kulturë Frënge	Bachelor	180 ECTS	15,000	15,000
4	Gjuhë Angleze	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
5	Mësuesi për Arsimin Fillor	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
6	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
7	Edukim fizik dhe sporte	Bachelor	180 ECTS	20,000	40,000
8	Histori-Gjeografi	Bachelor	180 ECTS	20,000	30,000
9	Shkenca Politike	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
10	Matematikë-Fizikë	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
11	Matematikë-Informatikë	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
12	Biologji- Kimi	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
13	Inxhinieri Informatike	Bachelor	180 ECTS	20,000	40,000
14	Teknologji Informacioni	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
15	Infermieri e përgjithshme	Bachelor	180 ECTS	20,000	120,000
16	Mami	Bachelor	180 ECTS	20,000	100,000
17	Administrim dhe Politika Sociale	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
18	Financë - Kontabilitet	Bachelor	180 ECTS	20,000	40,000
19	Menaxhim	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
20	Administrim Biznesi në Marketing	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
21	Menaxhim në Turizëm dhe Mëkpritje	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
22	*Teknologji Ushqimore	Bachelor	180 ECTS	20,000	30,000
23	Menaxhim Agrobiznesi	Bachelor	180 ECTS	15,000	25,000
24	Inxhinieri Agronomike	Bachelor	180 ECTS	15,000	25,000
25	Informatikë Biznesi	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
26	Ekonomiks	Bachelor	180 ECTS	20,000	20,000
27	Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme	Program Profesional 2- Vjeçar	120 ECTS	20,000	20,000
28	Menaxhim Biznesi Bujqësor	Program Profesional 2- Vjeçar	120 ECTS	20,000	20,000
29	Teknika e prodhimit të farave dhe fidanëve	Program Profesional 2- Vjeçar	120 ECTS	20,000	20,000
30	Menaxhim veterinar	Program Profesional 2- Vjeçar	120 ECTS	20,000	20,000
31	Shërbim Social	Program Profesional 2- Vjeçar	120 ECTS	20,000	20,000
32	Mbështetës zyre për komunikimin, bibliotekë dhe arkivë	Program Profesional 2- Vjeçar	120 ECTS	20,000	20,000
33	Asistent Menaxher	Program Profesional 2- Vjeçar	120 ECTS	20,000	20,000
34	*Mësuesi për Arsimin Special	Master Profesional	120 ECTS	60000	72000
35	Mësues për Arsimin Fillor	Master Profesional	120 ECTS	60000	72000
36	Sistemet Moderne të Telekomunikacionit dhe Teknologjitë e Internetit	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
37	Infermieristikë	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
38	Financë - Kontabilitet	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
39	Marketing	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
40	Menaxhim i turizmit atraksioneve dhe eventeve	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
41	Administrim Biznesi	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
42	Menaxhim i qëndrueshëm në agroturizëm	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
43	Drejtim Agrobiznesi	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
44	Administrim Publik	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
45	Bankë dhe Sigurime	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
46	Inxhinieri Agrare Profil Hortikulturë	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
47	Cilësia dhe Siguria Ushqimore	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
48	Marketingu Digjital	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
49	Guidë Turistike	Master Profesional	60 ECTS	60000	72000
50	Mësuesi për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
51	Mësuesi në Gjuhën Angleze	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
52	Mësuesi në Histori - Gjeografi	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
53	Mësuesi në Shkencat Sociale	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
54	Mësuesi në Matematikë-Fizikë	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
55	Mësuesi në Biologji-Kimi	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
56	Mësuesi në Edukim fizik, sport dhe shëndet	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
57	Etika dhe Liderhipi	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
58	Financë	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
59	Kulturë, Media dhe Editim	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
60	*Shkencat Bujqësore	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
61	*Shkenca Kompiuterike	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
62	Statistikë e Aplikuar	Master i Shkencave	120 ECTS	75000	90000
63	Programi i studimit në formimin psikopedagogjik	Program i formimit të vazhduar	35 ECTS	35000	-

* Shënim: Studentët përsëritës në programet e ciklit të dytë do të paguajnë të njëjtën tarifë për kredit, nëse si studentët e rregullt.

Tarifa e regjistrimit paraprak 1600 lekë/student në programet Bachelor dhe Profesionale

Tarifa e regjistrimit paraprak 2500 lekë/student në programet e studimit Master

Tarifa e regjistrimit paraprak 3000 lekë/student në programet e dyta të studimit

Tarifa e regjistrimit për konkurrin në programin "Edukim Fizik dhe Sporte" do të jetë 3000 lekë/student

Tarifa e rilëshimit të suplementit të diplomës 1000 lekë/ suplement diplome

* Në rastin e njohjes së krediteve nga njësitë bazë studentët nuk paguajnë për kreditet e njohura në programet Master.

* Programe të reja në proces hapjeje/riorganizimi

Tarifa për kredit për program të parë Master Profesional 1000 lekë/ kredit

Tarifa për kredit për program të dytë Master Profesional 1200 lekë/ kredit

Tarifa për kredit për program të parë Master i Shkencave 1250 lekë/ kredit

Tarifa për kredit për program të dytë Master i Shkencave 1500 lekë/ kredit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1346 prot

Korçë, më 26 / 06 / 2025

VENDIM

Nr. 380, datë 26.06.2025

PËR

NGRITJEN E KOMISIONIT PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR" NË "EDUKIM FIZIK DHE SPORTE", PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015, nenin 74, Udhëzimin nr.12, datë 30.06.2023 "*Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë*", në Urdhrin e përbashkët nr. 157, datë 03.06.2025 "*Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2025-2026*", si dhe në "*Rregulloren për zhvillimin e konkursit të pranimi në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte"*", Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.06.2025,

VENDOSI:

1. Ngritjen e komisionit të konkursit të testit praktik të kandidatëve për programin e studimit "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte":
 - Doc. Marjela Burda
 - Msc. Nesti Binishi
 - Msc. Julian Shishi
 - Msc. Pandush Tasellari
 - Msc. Pavlina Evro
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit të konkursit përcaktohen në "Rregulloren për zhvillimin e konkursit të pranimi në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1345 prot

Korçë, më 26 / 06 / 2025

VENDIM

Nr. 379, datë 26.06.2025

PËR

MIRATIMIN E DATËS SË KONKURRIMIT, PËR PRANIMET NË
PROGRAMIN E STUDIMIT "BACHELOR" NË "EDUKIM FIZIK DHE
SPORTE"

Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015, nenin 74, Udhëzimin nr.12, datë 30.06.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", në Urdhrin e përbashkët nr. 157, datë 03.06.2025 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2025-2026", si dhe në "Rregulloren për zhvillimin e konkursit të pranimit në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte"", Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.06.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë datën **18 gusht 2025**, si datë për zhvillimin e konkursit praktik për testet praktike të kandidatëve, për programin e studimit "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte".
2. Sekretaria mësimore brenda datës **7 gusht 2025** afishon në mjediset e fakultetit listën e aplikantëve nga U-Albania dhe dokumentet për regjistrimin e kandidatëve në konkurs.
3. Datat e regjistrimit të aplikantëve për konkursin do të jenë **8-14 gusht 2025**.
4. Në datën **15 gusht 2025**, sekretaria mësimore shpall listën e aplikantëve të regjistruar për konkurrim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1344 prot

Korçë, më 26 / 06 / 2025

VENDIM

Nr. 378, datë 26.06.2025

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PLANET MËSIMORE PËR VITIN
AKADEMIK 2025-2026

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma dh, si dhe në Statutin e Universitetit neni 18, pika 9, Senati Akademik pasi diskutoi propozimet e njësive kryesore për ndryshimet në planet mësimore, në mbledhjen e datës 26.06.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në planet mësimore të propozuara nga njësitet kryesore sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1150 prot.

Korçë, më 29.05.2025

VENDIM

Nr. 322, datë 29.05.2025

PËR
MIRATIMIN E KANDIDATËVE PËR REDAKTORË TË KOMISIONIT TË
BOTIMEVE PËR "BULETININ SHKENCOR" TË
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 46 pika 3 (anëtarët e komisioneve të përhershme të institucionit), në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", neni 31 pika 4, (anëtarët e komisioneve të përhershme të universitetit), si dhe në Rregulloren e Buletinit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli", neni 3, pika 3 dhe 4, Senati Akademik pasi diskutoi dhe votoi për redaktorë të Komisionit të Botimeve për "Buletinin Shkencor" në mbledhjen e datës 29.05.2025,

VENDOSI:

1. Të zgjedhë redaktorët e Komisionit të Botimeve për "Buletinin Shkencor" të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, si më poshtë vijon:
 - Dr. Eneida Çifligu – Shkencat Bujqësore
 - Prof.as.dr. Eljona Tasho – Shkencat Matematike dhe Informatike
 - Dr. Arben Gjata – Shkencat Natyrore
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1152 Prot.

Korçë, më 29/05 / 2025

VENDIM

Nr. 324, datë 29.05.2025

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË DOKUMENTEVE TË PRANIMIT
TË PROGRAMIT TË KUALIFIKIMIT TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK
LOKAL**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, VKM-në nr. 692, datë 5.10.2016, “Për miratimin e rregullores “kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre””, i ndryshuar, si dhe në UMTM nr. 258, datë 15.7.2024 “Për miratimin e rregullores për programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë dhe procedurës për akreditimin e tyre”, Senati Akademik pas miratimit të dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, në mbledhjen e datës 29.05.2025,

VENDOSI:

1. Të propozojë miratimin e kriterëve dhe të dokumenteve të pranimit të programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik lokal:

1.1 – Kriteret e përgjithshme të pranimit në programin e kualifikimit udhërrëfyes turistik lokal si më poshtë:

- të jetë mbi moshën 18 vjeç;
- të ketë mbaruar arsimin e mesëm ose arsimin e lartë
- të zotërojë një gjuhë ose gjuhët e huaja në të cilën udhërrëfyesi do të ushtrojë aktivitetin e tij

të mos ketë qenë i dënuar me heqje lirie për vepra penale të kryera me dashje;

Kritere specifike:

- Të kenë vendbanim në qarkun e Korçës (Korçë, Devoll, Maliq, Pustec, Kolonjë, Pogradec)

- Të kenë moshë 18-35 vjet
- 1.2 – Dokumentacioni që duhet të paraqitet pranë departamentit të Historisë dhe Gjeografisë:
 - Diploma e mbarimit të arsimit të mesëm së bashku me listën e notave të noterizuar
 - Dokumentin që vërteton njohjen dhe aftësitë komunikuese shumë të mira në gjuhën e huaj, në të cilën do të ofrojë shërbimet e tij udhërrëfyesi turistik. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj duhet të jetë të paktën i nivelit B2, sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët.
 - Vërtetim që nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale
 - Fotokopje të kartës së identitetit
 - Fotografi për dokument të aplikuesit në format elektronik
- 2. Grupi i punës dhe Drejtoria e Kurrikulave ngarkohen me zbatimin e procedurave të mëtejshme.
- 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1151 prot

Korçë, më 29 / 05 / 2025

VENDIM

Nr. 323, datë 29.05.2025

**PËR MIRATIM TË MODELIT TË CERTIFIKATËS DHE SUPLEMENTIT TË
PROGRAMIT TË KUALIFIKIMIT TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK LOKAL**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, VKM-në nr. 692, datë 5.10.2016, “Për miratimin e rregullores “kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre””, i ndryshuar, si dhe në UMTM nr. 258, datë 15.7.2024 “Për miratimin e rregullores për programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë dhe procedurës për akreditimin e tyre”, Senati Akademik pas miratimit të dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, në mbledhjen e datës 29.05.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë modelin e certifikatës dhe suplementit të programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik lokal sipas modelit bashkëngjitur.
2. Grupi i punës dhe Drejtoria e Kurrikulave, ngarkohen me zbatimin e procedurave të mëtejshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI**

Prof. dr. Lorenc Ekonom






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

CERTIFIKATË

Nr. Regjistrimi: _____



Znj./Z. _____

ka përfunduar programin e kualifikimit të

UDHËRREFTYESIË TUNISTIK në kategorinë _____, për periudhën _____

dhe ka përfunduar _____ kredite të barazvlefshme me _____ orë.

(Këto kredite nuk janë të transferueshme sipas sistemit ECTS)

Kjo certifikatë ofrohet në mbështetje të pikës 11 të nenit 5 të Ligjit nr. 258, datë 15.07.2024 "Për miratimin e rregullorës për programet e kualifikimit të Lëndës së rejturë dhe procedurës për abediminin e tyre"

DEKANI

REKTORI

SUPLEMENTI I CERTIFIKATËS

Të dhëna identifikuese për mbajtësin e certifikatës	
Mbiemri/at /	Emri/at /
Datëlindja (dd.mm.vvvv)	Numri i regjistrimit

Nr.	MODULET	KREDITE	ORË
1.	Mjedisi Fizik dhe Natyra në Zonën e Veçantë	20	10 orë leksion + 10 orë studim individual
2.	Gjeografia Humane dhe Zhvillimi Shoqëror e Urban në Zonën e Veçantë	20	10 orë leksion + 10 orë studim individual
3.	Arkeologjia, Prehistoria dhe Antikiteti në Zonën e Veçantë	20	10 orë leksion + 10 orë studim individual
4.	Historia e Përgjithshme e Zonës së Veçantë	20	10 orë leksion + 10 orë studim individual
5.	Diversiteti Kulturor i Zonës së Veçantë	20	10 orë leksion + 10 orë studim individual
6.	Arti & Arkitektura në Zonën e Veçantë	20	10 orë leksion + 10 orë studim individual
7.	Kohët Moderne	20	10 orë leksion + 10 orë studim individual
8.	Praktika dhe mësimi në terren	20	10 praktikë në terren + 10 orë praktikë personale
9.	Njohuri të përgjithshme për Shqipërinë	6	6 orë leksion
10.	Njohuri mbi teknikat e guidimit 1. Njohuri dhe Aftësi Profesionale të Udhërrëfyesit Turistik Aftësi Biznesi dhe Kushtet e Punës 2. Ndihma e Shpejtë	46	26 orë leksion + 20 orë studim individual
11.	Praktikë	108	70 orë praktikë në terren + 38 orë punë kërkimore
	GJITHSEJ	320	102 teori, 90 autodidakt, 128 praktikë në terren

Certifikimi i suplementit	
Data (dd.mm.vvvv)	Firma
Në cilësinë e	Vula zyrtare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1149 prot

Korçë, më 29 / 05 / 2025

VENDIM

Nr. 321, datë 29.05.2025

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT AKADEMIK 2025-2026

Mbështetur në urdhrin Nr. 145, datë 14.04.2025, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për caktimin e datës së fillimit dhe mbarimit të vitit akademik 2025-2026, në institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.05.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë strukturën e vitit akademik 2025-2026, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof.dr. Lorenc Ekonomi



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
STRUKTURA E VITIT AKADEMIK 2025 – 2026

		SEMESTRI I PARË												
Tetor	6	7	8	9	10	11	12	Java 1		6 Tetor – 10 Tetor				
	13	14	15	16	17	18	19	Java 2		13 Tetor – 17 Tetor				
	20	21	22	23	24	25	26	Java 3		20 Tetor – 24 Tetor				
	27	28	29	30	31	1	2	Java 4		27 Tetor – 31 Tetor				
Nëntor	3	4	5	6	7	8	9	Java 5		3 Nëntor – 7 Nëntor		22 Nëntor		
	10	11	12	13	14	15	16	Java 6		10 Nëntor – 14 Nëntor		Dita e Alfabetit		
	17	18	19	20	21	22	23	Java 7		17 Nëntor – 21 Nëntor		28, 29 Nëntor		
	24	25	26	27	28	29	30	Java 8		24 Nëntor – 28 Nëntor		Dita e Pavarësisë dhe Çlirimit		
Dhjetor	1	2	3	4	5	6	7	Java 9		1 Dhjetor – 5 Dhjetor		8 Dhjetori		
	8	9	10	11	12	13	14	Java 10		8 Dhjetor – 12 Dhjetor		Dita Kombëtare e Rinisë		
	15	16	17	18	19	20	21	Java 11		15 Dhjetor – 19 Dhjetor				
	22	23	24	25	26	27	28	Pushimet e Dimrit (22 Dhjetor - 4 Janar) 25 Dhjetor Krishtlindja						
Janar	29	30	31	1	2	3	4	Java 12		5 Janar – 9 Janar				
	5	6	7	8	9	10	11	Java 13		12 Janar – 16 Janar				
	12	13	14	15	16	17	18	Java 14		19 Janar – 23 Janar				
	19	20	21	22	23	24	25	Java 15		26 Janar – 30 Janar				
Shkurt	26	27	28	29	30	31	1	Sezoni i Dimrit: 2 Shkurt – 20 Shkurt (7, 8, 14, 15 Shkurt, jo datë provimi)						
	2	3	4	5	6	7	8	Java 1		23 Shkurt – 27 Shkurt				
	9	10	11	12	13	14	15	Java 2		2 Mars – 6 Mars				
	16	17	18	19	20	21	22	Java 3		9 Mars – 13 Mars				
Mars	23	24	25	26	27	28	29	Java 4		16 Mars – 20 Mars		14 Mars (Dita e Verës)		
	30	31	1	2	3	4	5	Java 5		23 Mars – 27 Mars		20 Mars (Fiter Bajrami)		
	6	7	8	9	10	11	12	Java 6		30 Mars – 3 Prill		22 Mars (Sulltan Nevruz)		
	13	14	15	16	17	18	19	Java 7		6 Prill – 10 Prill		5 Prill (Pashkët Katolike)		
Prill	20	21	22	23	24	25	26	Java 8		13 Prill – 17 Prill		12 Prill (Pashkët Ortodokse)		
	27	28	29	30	1	2	3	Java 9		20 Prill – 24 Prill				
	4	5	6	7	8	9	10	Java 10		27 Prill – 1 Maj		1 Maj (Dita e punëtorëve)		
	11	12	13	14	15	16	17	Java 11		4 Maj – 8 Maj				
Maj	18	19	20	21	22	23	24	Java 12		11 Maj – 15 Maj				
	25	26	27	28	29	30	31	Java 13		18 Maj – 22 Maj				
	1	2	3	4	5	6	7	Java 14		25 Maj – 29 Maj		27 Maj (Kurban Bajrami)		
	8	9	10	11	12	13	14	Java 15		1 Qershor - 5 Qershor				
Qershor	15	16	17	18	19	20	21	Sezoni i Verës: 8 Qershor – 26 Qershor (13, 14, 20, 21 Qershor, jo datë provimi)						
	22	23	24	25	26	27	28	Mbrotjtja e Diplomës / Provimi i Formimit 3, 4 Korrik						
	29	30	1	2	3	4	5	Pushimet e Verës (7 Korrik - 30 Gusht)						
	6	7	8	9	10	11	12							
13	14	15	16	17	18	19								
20	21	22	23	24	25	26								
Korrik	27	28	29	30	31	1	2	Sezoni i Vjeshtës 1 Shtator – 11 Shtator (5 Shtator, Shënjtërimi i Nënë Terezës, 7 Shtator jo datë provimi)						
	3	4	5	6	7	8	9							
	10	11	12	13	14	15	16							
	17	18	19	20	21	22	23							
Gusht	24	25	26	27	28	29	30	Sezoni para Diplome 17, 18 Shtator						
	31	1	2	3	4	5	6							
	7	8	9	10	11	12	13							
	14	15	16	17	18	19	20							
Shtator	21	22	23	24	25	26	27	Mbrotjtja e Diplomës / Provimi i Formimit 24, 25 Shtator						
	28	29	30											



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1153 Prot.

Korçë, më 29/ 05 / 2025

VENDIM

Nr. 325, datë 29.05.2025

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE DHE MËNYRËN E PAGESËS SË STAFIT TË PROGRAMIT TË KUALIFIKIMIT TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK LOKAL

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, VKM-në nr. 692, datë 5.10.2016, “Për miratimin e rregullores “kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre””, i ndryshuar, si dhe në UMTM nr. 258, datë 15.7.2024 “Për miratimin e rregullores për programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë dhe procedurës për akreditimin e tyre”, Senati Akademik pas miratimit të dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, në mbledhjen e datës 29.05.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë e tarifat dhe mënyrën e pagesës së stafit të programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik lokal
2. Tarifa e regjistrimit në program të jetë 1600 lekë;
3. Tarifa e plotë e programit të llogaritet 100 lekë/kredit, 32000 lekë total
4. Shpenzimet për pagesën e orëve mësimore dhe administrative do të mbulohen nga të ardhurat e krijuara nga aplikantët.
5. Të ardhurat e krijuara nga trajnimet do të shkojnë 30% për institucionin dhe 70% për pagesën e orëve mësimore dhe administrative të stafit të përfshirë.
6. Ky vendim t’i përcillet Bordit të Administrimit.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI**

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1154 prot.

Korçë, më 29.05.2025

VENDIM

Nr. 326, datë 29.05.2025

PËR

**MIRATIMIN E KANDIDATËVE PËR ANËTARË BORDI SHKENCOR TË
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË**

Mbështetur në Rregulloren e Buletinit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli", neni 2 pika 2, Senati Akademik pasi votoi për anëtarët e Bordi Shkencor, në mbledhjen e datës 29.05.2025,

VENDOSI:

1. Të zgjedhë Prof.as.dr. Ilir Niçko, personel akademik me kohë të plotë, anëtar Bordi Shkencor të Buletinit Shkencor, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, përfaqësues i Fakultetit të Bujqësisë.
2. Të miratojë anëtarët e Bordit Shkencor të Buletinit Shkencor, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, profesorë të huaj dhe shqiptarë që nuk janë pjesë e Universitetit, pas propozimit të departamenteve, si më poshtë:
 - Associate Professor Mihaela Culea, PhD "Vasile Alecsandri University of Bacau" (Rumani)
 - Associate Professor Brindusa-Mariana Amalancei, "Vasile Alecsandri University of Bacau" (Rumani)
 - Eleni Grivas, "Universiteti i Kozanit"
 - Gentian Kostandini, "University of Georgia"
 - Genci Capi, "Universiteti i Tokios", Japoni
 - Julia Vullnetari, "University of Southampton"
 - Mimoza Zografi Shpata
 - Fatbardh Sallaku, "Universiteti Bujqësor i Tiranës"
 - Artan Hoxha, "Universiteti i Tiranës"
 - Dhimitri Bello, "Universiteti i Tiranës"
 - Akli Fundo, "Universiteti Politeknik i Tiranës"
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 951 prot

Korçë, më 29/04 / 2025

VENDIM

Nr. 254, datë 29.04.2025

PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË KËSHILLIT STUDENTOR TË
UNIVERSITETIT
"FAN S. NOLI", KORÇË

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 99, pika 6, si dhe në Statutin e Universitetit neni 80, pika 8, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 29.4.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë Kërkesën e Këshillit Studentor të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë për miratimin e buxhetit për Këshillin Studentor, për vitin 2025, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI
Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 950 prot.

Korçë, më 29.04.2025

VENDIM

Nr. 253, datë 29.04.2025

PËR
MIRATIMIN E KANDIDATËVE PËR REDAKTORË TË KOMISIONIT TË
BOTIMEVE PËR "BULETININ SHKENCOR" TË
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 46 pika 3 (anëtarët e komisioneve të përhershme të institucionit), në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", neni 31 pika 4, (anëtarët e komisioneve të përhershme të universitetit), si dhe në Rregulloren e Buletinit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli", neni 3, pika 3 dhe 4, Senati Akademik pasi diskutoi dhe votoi për redaktorë të Komisionit të Botimeve për "Buletinin Shkencor" në mbledhjen e datës 29.04.2025,

VENDOSI:

1. Të zgjedhë redaktorët e Komisionit të Botimeve për "Buletinin Shkencor" të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, si më poshtë vijon:
 - Dr. Klaudeta Merollari – Shkencat Ekonomike
 - Dr. Alma Karasaliu – Shkencat Filologjike
 - Dr. Evjonda Pylli – Shkencat e Edukimit
 - Dr. Suela Dinellari – Shkencat Humane
 - Dr. Zhinzela Qyli – Shkencat e Shëndetit Human
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 949 prot.

Korçë, më 29.04.2025

VENDIM

Nr. 252, datë 29.04.2025

PËR
MIRATIMIN E KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË BORDIT SHKENCOR TË
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË

Mbështetur në Rregulloren e Buletinit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli", neni 2 pika 2, Senati Akademik pasi diskutoi dhe votoi për anëtarë të Bordit Shkencor në mbledhjen e datës 29.04.2025,

VENDOSI:

1. Të zgjedhë anëtarët e Bordit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, si më poshtë vijon:
 - Prof.as.dr. Mirela Cini – Fakulteti Ekonomik
 - Prof.as.dr. Eris Rusi- Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë
 - Prof.as.dr. Magdalini Vampa – Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 948 prot

Korçë, më 29/04 / 2025

VENDIM

Nr. 251, datë 29.04.2025

PËR
MIRATIMIN E RREGULLOREVE TË DEPARTAMENTEVE TË
FAKULTETIT TË EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d) si dhe në Statutin e Universitetit neni 18, pika 6, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 29.04.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloret e brendshme të Departamenteve, të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, si më poshtë:
 - Rregullore e Departamentit të Gjuhë-Letërsisë
 - Rregullore e Departamentit të Histori-Gjeografisë
 - Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja
 - Rregullore e Departamentit të Edukimit
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonom





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 720 prot

Korçë, më 26 / 03 / 2025

VENDIM

Nr. 197, datë 26 .03 .2025

PËR

NDRYSHIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN E APELIMIT
(PËRFAQËSUES I STUDENTËVE)

Në mbështetje të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UNIKO", neni 40 pika 1, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.03.2025,

VENDOSI:

1. Të ndryshohet si përfaqësues i studentëve z. Kodhel Zere, në Komisionin e Apelimit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.
2. Të zgjedhë si përfaqësues të studentëve në Komisionin e Apelimit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, znj. Ina Bala, studente në programin e studimit "Informatikë Biznesi", viti i dytë, Bachelor, pranë Fakultetit Ekonomik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 719 prot

Korçë, më 26 / 03 / 2025

VENDIM

Nr. 196, datë 26 . 03 . 2025

PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT
"MASTER I SHKENCAVE"
NË
"SHKENCAT BUJQËSORE",
FAKULTETI I BUJQËSISË

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika dh, në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 18 pika 9, si dhe të Udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar të MASR, Senati Akademik, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Agronomisë, Fakulteti i Bujqësisë, në mbledhjen e datës 26.03.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e njësive bazë dhe të dekanatit të Bujqësisë, për hapjen e programit të studimit, "Master i Shkencave" në "Shkencat Bujqësore", për vitin akademik 2025-2026.
2. Grupi i punës dhe Drejtoria e Kurrikulave, ngarkohen me zbatimin e procedurave të aplikimit në portalin zyrtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomid





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 718 prot

Korçë, më 26 / 03 / 2025

VENDIM

Nr. 195, datë 26 . 03 . 2025

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR REKRUTIMIN E PERSONELIT
AKADEMIK DHE NDIHMËSAKADEMIK NË UNIVERSITETIN "FAN S.
NOLI"

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d), si dhe në Statutin e Universitetit, neni 18, pika 6, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.03.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren për rekrutimin e personelit akademik dhe ndihmësakademik në Universitetin "Fan S. Noli", sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 717 prot

Korçë, më 26 / 03 / 2025

VENDIM

Nr. 194, datë 26.03.2025

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË BULETINIT SHKENCOR TË
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d), si dhe në Statutin e Universitetit, neni 18, pika 6, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.03.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Buletinit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli", sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 478 prot

Korçë, më 17 / 02 / 2025

VENDIM

Nr. 131, datë 17.02.2025

PËR
MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR TË GJITHA PROGRAMET E
STUDIMIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË
PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Mbështetur në Statutin e Universitetit neni 18, pika 26, si dhe bazuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018, (I ndryshuar) pika 2.7, gërma a, Senati Akademik pasi diskutoi për propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore në lidhje me kuotat e pranimi për vitin akademik 2025-2026, për të gjitha programet e studimit, në mbledhjen e datës 17.02.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimi për të gjitha programet e studimit për vitin akademik 2025-2026, bazuar në propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore.
2. T'i përcjellë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit kuotat e miratuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 448 prot

Korçë, më 12 / 02 / 2025

VENDIM

Nr. 125, datë 12.02.2025

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT PËR TË GJITHA PROGRAMET
STUDIMIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", PËR VITIN AKADEMIK
2026-2027

Mbështetur në Statutin e Universitetit neni 18, pika 26, si dhe në shkresën e MAS, nr. 7955/1 prot, datë 19.12.2024, "Për publikimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2026-2027", pasi diskutoi propozimet e departamenteve në lidhje me kriteret e pranimit në programet e studimit për vitin akademik 2026-2027, Senati Akademik në mbledhjen e datës 12.02.2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve të pranimit për të gjitha programet e studimit për vitin akademik 2026-2027, sipas propozimeve përkatëse të departamenteve.
2. T'i përcjellë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit kriteret e miratuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 48 prot

Korçë, më 13 / 01 / 2025

VENDIM

Nr. 12, datë 13.01.2025

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PËRGJITHSHME DHE NUMRIN E
PERSONELIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË, NË TË
GJITHA NIVELET, PËR VITIN 2025

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma ç), të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 18, pika 5, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.01.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, në të gjitha nivelet, për vitin 2025, sipas materialit bashkëngjitur.
 2. T'i propozojë për miratim Bordit të Administrimit, strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, në të gjitha nivelet, për vitin 2025.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof.dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 82 prot

Korçë, më 13 / 01 / 2025

VENDIM

Nr. 16, datë 13.01.2025

PËR

MIRATIMIN E MANUALIT TË CILËSISË TË UNIVERSITETIT
"FAN S. NOLI", KORÇË

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma j) si dhe në Statutin e Universitetit neni 18, pika 22, dhe neni 84 pika 3, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 13.1.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë Manualin e Cilësisë së Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Manuali i miratuar me vendim nr. 300, datë 10.07.2020, të Senatit Akademik shfuqizohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 80 prot

Korçë, më 13 / 01 / 2025

VENDIM

Nr. 14, datë 13.01.2025

PËR
DISA SHFUQIZIME NË RREGULLOREN E UNIVERSITETIT "FAN S.
NOLI", KORÇË

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d), të Statutit të Universitetit, neni 18, pika 6, si dhe Rregullores së Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 115, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.01.2025,

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të nenit 45 dhe pikën 3 të nenit 47 të Rregullores së Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 113, datë 30.03.2023.
2. Vendimi t'i përcillet të gjitha njësive përbërëse të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof.dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 79 prot

Korçë, më 13 / 01 / 2025

VENDIM

Nr. 13, datë 13. 01. 2025

PËR

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN MBI PROCEDURËN PËR APLIKIM,
MIRATIM DHE ZBATIM TË PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA TË
ARDHURAT E UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË**

Mbështetur, në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.05.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1 gërma d), si dhe në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 18 pika 6, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.01.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e nenit 5, pika 3, gërma ii) të "Rregullores mbi procedurën për aplikim, miratim dhe zbatim të projekteve të financuara nga të ardhurat e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë", miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 69, datë 22.02.2024, si më poshtë vijon:
"Në zërat buxhetorë 2c, 2d, 2e nuk ka kufizime në % në lidhje me pjesën e mbetur të buxhetimit në zërat buxhetorë 2a dhe 2b".
2. Të miratojë ndryshimin e emërimit të nenit 7, si më poshtë vijon:
"Aplikimi, miratimi, zbatimi, përfundimi dhe dorëzimi"
3. Të miratojë ndryshimin e nenit 7, pika 5, gërma b) dhe c), të "Rregullores mbi procedurën për aplikim, miratim dhe zbatim të projekteve të financuara nga të ardhurat e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë", miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 69, datë 22.02.2024, si më poshtë vijon:
b) Grupi/et kërkimor/e janë të detyruara të dorëzojnë raportin përfundimtar të realizimit të projektit jo më vonë se 2 (dy) javë pas përfundimit të projektit. Raporti përfundimtar dorëzohet pranë Drejtorisë së Projekteve dhe Kërkimit Shkencor. Në rast kur kjo drejtori nuk e miraton raportin, grupi i punës është i detyruar të bëjë korrigjimet dhe rregullimet sipas propozimeve.

Në rast se këto propozime nuk zbatohen, projekti quhet i dështuar dhe grupi i punës është i detyruar të kthejë të gjithë shumën e shpenzuar në kuadër të projektit.

c) Në ratet kur raporti përfundimtar miratohet, Drejtoria e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, në bashkëpunim me grupin e punës parashikon zbatimin e përhapjes së rezultateve. Në këtë fazë prezantohen qartë rezultatet e projektit, arritjet, mos-arritjet dhe arsyet, si dhe shpenzimet e bëra, sipas zërave të mëposhtëm: qëllimi dhe objektivat, metodologjia e projektit, ndryshimet e bëra në objektivat origjinale (nëse ka të tilla), zbatimi i projektit, rezultateve, vlerësimi i tyre, rekomandime, përfitimet e institucionit, promovimi i rezultateve, menaxhimi i rreziqeve të shfaqura gjatë aplikimit, shpenzimet e buxhetit.

4. Vendimi t'i përcillet për miratim Bordit të Admisnitimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI
Prof. dr. Lorenc Ekonomi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 81 prot

Korçë, më 13/ 01 / 2025

VENDIM

Nr. 15, datë 13.01.2025

PËR

DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E SEKTORIT TË STUDIMEVE DHE
SEKTORIT TË TIK

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d), si dhe të Statutit të Universitetit, neni 18, pika 6, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.01.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 13, II, të nenit 10 të Rregullores së Sektorit të Studimeve dhe Sektorit të TIK, miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 113, datë 30.03.2023, si më poshtë vijon:
"Specialistët e sekretarisë së sistemit: Marrin nga specialistët e sekretarive mësimore rezultatet e ekuivalentimit të lëndëve sipas vendimeve të komisioneve të ekuivalentimit dhe i ngarkojnë ato në sistem për çdo student, deri në fund të muajit tetor."
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI

Prof.dr. Lorenc Ekonomi

